



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 86/10

Prishtinë, më 07.07.2010, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Gani Koci, Naser Osmani, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Armend Zemaj, Shkumbin Demaliaj, Xhevdet Neziraj, Besa Gaxheri, Suzana Novobërdaliu, Hajdin Abazi, Safete Hadërgjonaj dhe Mufera Sinik.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza zv. Ministër i MEF-it, Agim Krasniqi Drejtor i Buxhetit në MEF, Arbëresha Raça-Shala Sekretarja e Gjykatës Kushtetuese, Alexander Beetz, Teki Shala, Ramadan Islami nga GTZ, monitorues nga Zyra e presidentit, KDI, OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me rishikimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010**
- 3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Komponentin Rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Mbikëqyerjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me amendamente;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente;**
- 7. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me rishikimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010

Kryesuesi, thekso se kërkesa e Gjykatës Kushtetuese nuk është në përputhje me atë që është planifikuar dhe miratuar në fillim të vitit. Diferencat janë në mallrat dhe shërbimet, si dhe pagat e mëditjet dhe te investimet kapitale. Kërkesa në fillim të vitit për shpenzime kapitale ka qene shume me e madhe per vitin 2010 mirëpo ne kemi kërkuar nje projekt te detajuar mbi lokalitetin, koston e përgjithshme, lejen etj, që te na ofrohet dhe per këtë arsye kërkesa për këtë projekt nuk është aprovuar. Në baze të rishikimit të buxhetit Gjykata Kushtetuese ka kërkuar në linjën Paga dhe meditje, nje rritje prej 246,875€, dhe se kjo shumë është përfshirë në buxhetin e përgjithshëm dhe qeveria pa nje analizë të detajuar, dhe ne si komision do te kemi nje qëndrim krejt tjetër. Ajo që ka qenë shqetësuese për ne është ekzekutimi i buxhetit në linjën “paga dhe meditje”, dhe nga dokumentet që kam siguruar, shifet se në të gjitha rastet te pagat e te punësuarve ka shkelje te ekzekutimit te buxhetit nga ajo qe eshte miratuar ne Kuvend. Çështja tjetër shqetësuese është se stafi civil në Gjykatën Kushtetuese nuk e ka trajtuar veten si shërbyes civil edhe pse me ligj thuhet se i nënshtrohen të gjitha Ligjeve të Shërbimit Civil dhe në këtë formë pagesat janë bërë më të larta, siq është rasti i Sekretarit të Gjykatës Kushtetuese, që ka pagën një herë më të lartë se paga e sekretareve tjerë shtetëror. Në vazhdim bëri disa pyetje:

Sa punëtor ka Gjykata Kushtetuese?

Sa ka qenë shuma mujore për paga dhe meditje për këta punëtor dhe a kanë marrë këta punëtor edhe pjesën tjetër të pagave të punëtorëve që nuk janë të punësuar, që sipas ligjit do të duhej të ishin 55, ndërsa janë të punësuar vetëm 28 punëtor?

A janë trajtuar në çështjen e pagave dhe meditjeve, anëtarët e Gjykatës Kushtetues sipas Ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe sipas Ligjit të Buxhetit 2010 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës?

A janë trajtuar si shërbyes civil punëtorët e gjykatës (përfshirë edhe sekretarin), në procesin e pagave?

Arbëresha Raça-Shala, njoftoi se Gjykata Kushtetuese në përgatitjen e rishikimit të buxhetit, ka punuar në bashkëpunim me ekspertet e brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë ndihmën e ekspertëve të ICO-së dhe USAID-it, dhe mënyrë reale ka paraqitur kërkesat e saj me qëllim të krijimit të një baze të funksionimit të Gjykatës. Kërkesa jone është më e ulët se në fillim të vitit dhe kjo ka ndodhur për arsye se ne fillim kemi kërkuar mjete për ndërtimin e aneksit shtesë për Gjykatën. Po ashtu zvogëlimi i kërkesave tona buxhetore në rishikim ka ardhur edhe si rezultat i ndihmës që na kane ofruar donatorët e ndryshëm. Gjykata Kushtetuese në bazë të rekomandimeve, ka pranuar që ta zvogëloje numrin prej 9 punëtorëve dhe këta punëtor mbulohen nga ICO dhe tre Këshilltar Ligjor dhe tre përkthyes pagat i marrin nga ICO. Njoftoi se Gjykata Kushtetuese ka 28 punëtorë, prej të cilëve 22 janë staf civil dhe 6 gjyqtar, ndërsa janë konkurset e hapura për punëtorët tjerë.

Kryesuesi, rikujtojë se paga bruto e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese sipas Ligjit të Buxhetit të miratuar në Kuvend është 1,452 €, ndërsa sipas dokumentit që flet për ekzekutimin e tyre nga ana juaj, del se paga bruto e Kryetarit të Gjykatës është 2,261€, na sqaroni se mbi bazë të cilave vendimeve Gjykata Kushtetuese ka bërë këto pagesa?

Arbëresha Raça-Shala, theksoi se Gjykata Kushtetuese e menaxhon ne mënyrë te pavarur buxhetin e saj. Niveli i pagës së gjyqtarit të gjykatës kushtetuese është 1.3 herë me i lartë se gjykatësit e gjykatës supreme. Sa i përket këshilltareve ligjore pagat e tyre përcaktohen ne bazë të rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese. Ne baze te nenit 18 te ligjit ne fuqi thuhet se zyrtaret Ligjor nuk janë shërbyes civil. Sa i përket shtesave dhe mëditjeve janë caktuar ne baze te punes shtese qe e kane per shkak te natyrës se punes se gjyqtarëve. Ne kohën kur është aprovuar paga e sekretarit permanent nuk ka pasur ligj per paga, citojë nenin 12, pikën 4 qe thotë se kushtet e punes dhe paga e sekretares se gjykatës kushtetuese, përcaktohen në bazë te rregullores se punës të Gjykatës Kushtetuese. Sekretaren e zgjedhin Gjyqtaret e nuk e zgjedh komisioni per emërimet te larta, qe i zgjedhin sekretaret e institucioneve tjera dhe këtu është dallimi.

Naser Osmani, thoni se përmes rregullorës së brendshme keni përcaktuar rrogat e që në fakt i keni rritur ato, çka do të thotë se keni shmangur rekomandimet e këtij Komisioni dhe vendimet e Kuvendit, që miraton Ligjin e Buxhetit, ku përfshihen të gjitha organizatat buxhetore.

Armend Zemaj, pasi kemi qëndrime diametralisht të kundërta, të mundohemi që ta gjejmë një zgjidhje, dhe kjo çështje të mos bëhet temë debati. Duke pasur parasysh faktin se duhet respektuar vendimet e Kuvendi dhe kur shifet se Gjykata mbron mendimin se ka vepruar konform ligjit, duhet analizohet se i është interpretuar ligji në çështjen e ekzekutimit të pagave, në këtë drejtim mund të ndihmojnë edhe përfaqësuesit e MEF-it, në dhënien e sqarimeve.

Kryesuesi, vlerësoi se Gjykata Kushtetuese në ekzekutimin e buxhetit ka shkel vetë ligjin. Në ekzekutimin e buxhetit secili institucion është i pavarur, por të ndarjet buxhetore ka norma dhe ka dispozita dhe ekzekutimi duhet te bëhet në bazë të këtyre normave dhe dispozitave.

Shkumbin Demaliaj, përkundër faktit se Gjykata Kushtetuese është themeluar vonë dhe mund ti ketë pasur mangësitë e veta në konsolidim, megjithatë është dashur të respektohet ligji për çështjen që po flasim. Ndoshta kemi mangësi ligjore, por megjithatë ligj duhet respektohet, dhe nëse mendohet se nuk është i mirë, egzistojne procedurat për të ndryshuar atë ose per me nxjerrë nje ligj tjetër.

Besa Gaxherri, kërkoi nga sekretarja e Gjykatës Kushtetuese të jetë konkrete në përgjigjen e pyetjeve. Më interes është të dijmë pse keni kërkuar këtë shumë shtesë për paga? Pse nuk e keni plotësuar numrin e punëtorëve? Ju i menaxhoni mjetet në mënyrë të pavarur, por ju duhet ta arsyetoni se si i keni menaxhuar ato mjete.

Arbëresha Raça-Shala, kjo shume kërkohet per kompenzimin e punëtorëve qe janë ne proces të rekrutimit dhe 16 punëtor janë në fazën e rekrutimit.

Besa Gaxherri, duke u ndërlidhur me parafolësen, theksoi se asnjë organizatë buxhetore nuk ka drejtë të parashtrojë kërkesë per punëtorët qe nuk i ka të punësuar. Ne nuk mund të imagjinojmë se ku i keni punëtorët, kur do t'i merrni, e ta ndajmë buxhetin paraprakisht, prandaj duhet shikuar Ligjin për menaxhimin e financave publike, për të parë se kur bëhet rishikim dhe kur ndahen mjetet dhe në këtë formë të parashtroni kërkesat.

Naser Osmani, kërkoi një sqarim për dy projektet që duken të njëjta, projekti softuer për paisje të IT-së dhe projekti për digjitalizimin e Gjykatës?

Arbëresha Raça, njoftoi se ekziston projektin per avancimin e gjykatores sepse gjykatorja nuk ka paisje digjitale, digjitalizimi përfshinë softuerin dhe te gjitha paisjet tjera.

Kryesuesi, propozimi i komisionit është që në linjën paga dhe mëditje buxheti të jetë më i madhë për 74,000€, ndërsa buxheti në kategoritë tjera mbetet sipas asaj që është përfshirë në buxhetin e rishikuar nga qeveria dhe që është sjellur në Kuvend.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që të miratojë kërkesën shtesë buxhetore të Gjykatës Kushtetuese, në kategorinë paga dhe mëditje, në vlerë prej 74,000€.
- II. Institucionet përkatëse të merren me atë se si po ekzekutohet buxheti nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi, njoftoi se grupi punues ka punuar me përkushtim të madh në përgatitjen e këtyre amendamenteve dhe gjatë gjithë punës ka pasur asistencën e ekspertëve të MEF-it, Bankës Qendrore dhe USAID-it.

Pas që nuk pati vërejtje, Kryesuesi konstatoi se me njëmbëdhjetë vota Për, Asnjë Kundër dhe një Abstenim (znj. Besa Gaxherri), Komisioni nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Miratohen propozim-amendamentet e grupit punues të Komisionit për Buxhet e Financa për Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Projektligji me amendamente procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurë të mëtutjeshme.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë

Pas që nuk pati vërejtje, Kryesuesi konstatoi se me njëmbëdhjetë vota Për, asnjë Abstenim dhe një Kundër (znj. Besa Gaxherri), Komisioni nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- II. Miratohen propozim-amendamentet e Komisionit për Buxhet e Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë. Projektligji me amendamente procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurë të mëtutjeshme.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Komponentin Rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Mbikëqyerjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, me amendamente

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Projektligji për Komponentin Rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore.
- II. Amendamentet e komisionit funksional – Komisioni për Mbikëqyerjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës me raportin e Komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Projektligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore.
- II. Amendamentet e komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

7. Të ndryshme.

Nuk pati ndonjë çështje për tu diskutuar

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Gani Koci
